

## PROCESVERBAL

## **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

## **OBJEKTI I PROKURIMIT:**

“Përmirësimi i transportit lokal dhe urban me ndërhyrje në rrugë dhe trotuare: Lot 3- " Rikualifikim i rrugës hyrëse Ksamil, bashkia Sarandë".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 243,851,960.66 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor GOA për periudhën 2024-2026. Kodi i Projektit 24AE801.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

## KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kio pikë përmbushet sipas pikës 1-a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates në procedurën e prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuaara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkeseve të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatile": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatushme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatile brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjeter të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistikës miratuar", i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuaara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitës dhe pasivit".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuaara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkeseve të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatile: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatushme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatile brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjeter të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpresa publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financier standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të janë minimalisht në vleren 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

**2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimitari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:**

## PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

- |       |     |   |  |
|-------|-----|---|--|
| N.P - | 1.  | A | Punime gjermimi në tokë.   |
| N.P - | 4.  | C | Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.                             |
| N.P - | 5.  | B | Punime nëntoksore, ura e vepra arti.   |
| N.P - | 7.  | B | Ujesjelesa, gazsjelesa, vajsjelesa, vepra kullimi e vaditje.   |
| N.P - | 11. | B | Ndërtimë për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. |
| N.P - | 12. | A | Punime të inxhinierisë së mjedisit.  |

## PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

- |       |     |   |  |
|-------|-----|---|--|
| N.S – | 1.  | A | Punime per prishjen e ndertimeve   |
| N.S – | 4.  | A | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese |
| N.S – | 6.  | A | Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.   |
| N.S – | 8.  | A | Ndërtimë parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.  |
| N.S – | 18. | A | Punime topogeodezike.  |

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimitari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimitari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nenin 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet te sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në perputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P– 1 A	Punime gërmimi në tokë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi &gt; 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet</li> <li>- Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km</li> <li>- Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III</li> </ul>	0-21 mln leke	3,124,780 leke
N.P–4 C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale .	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri</li> <li>- Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri</li> <li>- FV Bordura betoni 20x35 cm</li> <li>- Pllaka guri me trashesi t=7cm te boxharduara me forma te rregullta</li> <li>- Shtrese stabilizant t=15cm</li> <li>- Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri</li> </ul>	51-100 mln leke	98,600,399 leke
N.P–5 B	Punime nëntoksore, ura e vepra arti.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Struktura monolite betoni C 12/15 (2)</li> <li>- Struktura monolite betoni C 16/20</li> <li>- F V tombino kendrejtje b/a C 16/20</li> <li>- F.V. Zgara hekuri D8mm , 20x20 cm</li> </ul>	21-50 mln leke	25,482,365 leke
N.P–7 B	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	<ul style="list-style-type: none"> <li>- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm</li> <li>- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm</li> <li>- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm</li> <li>- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=600 mm</li> </ul>	21-50 mln leke	43,130,069 leke
N.P– 11 B	Ndërtime për N/stacionet, kabinet e transformat orëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Cmontim i shtylle egzistuese</li> <li>- Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret)</li> <li>- F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement</li> <li>- FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086</li> <li>- F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m</li> <li>- F.V. Shtylle metalike H=8ml perfshire ndricuesin LED morseteri , siguresa &amp; kapak</li> <li>- F.V. Shtylle metalike H=4ml perfshire ndricuesin LED morseteri , siguresa &amp; kapak</li> <li>- F.V. Spote ndrycues trotuari</li> <li>- F.V. Kabell elektrike FG7OR 5x25 mm<sup>2</sup></li> <li>- F.V. Kabell elektrike FG7OR 5x16mm<sup>2</sup></li> <li>- F.V. Kabell elektrike FG7OR 3x15 mm<sup>2</sup></li> <li>- F.V. Tub plastik flesibel elektriku D75 cm</li> </ul>	21-50 mln leke	33,389,913 leke
N.P– 1 2 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- F.V. Fidane Lule dekorative</li> <li>- F.V. Fidane Peme dekorative</li> <li>- F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander"</li> <li>- Preje e sistemim pemesh ø 21 ~ 40 cm</li> </ul>	0-20 mln leke	5,163,834 leke

N.S-1. A	Punime per prishjen e ndertimeve	- Prishje trotuari ekzistues - Prishje shtresa betoni - Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	0-20 mln leke	7,697,188 leke
N.S-4. A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	- Mur guri themel e xokol me llaç te perzier M 15 - Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç te perzier M 15 - Veshje mure rrithimi me pllaka guri	0-20 mln leke	13,079,972 leke
N.S-6. A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	- FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm - FV tabela te medha informative te thjeshta + bazamenti - Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm. Bikomponente (sprajt) - Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Termoplastike (paste) -	0-20 mln leke	3,322,896 leke
N.S-8. A	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	- F.V. Stola betonarme - F.V. Kosha per mbeturina	0-20 mln leke	3,758,060 leke
N.S-18. A	Punime topogeodezike.	- Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik	0-20 mln leke	

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedis
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përbledhës të Vetëdekclarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdekclarimit duhet të përbajë kërkosat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përparrë publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislativi për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin përfshi patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, përfshi kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpëra publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi i stafit kryesor:

*Punimet apo veprimtaritë konkrete përfshi cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:*

Inxhinier Ndërtimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plaka guri me trashesi t=7cm te boxharduara me forma te rregulla</li> <li>- Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri</li> <li>- Shtrese binderi me granil guri kave, 6cm, me makineri</li> <li>- FV Bordura betoni 20x35 cm</li> <li>- Shtrese stabilizant t=15cm</li> <li>- Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri</li> <li>- Struktura monolite betoni C 12/15 (2)</li> <li>- Struktura monolite betoni C 16/20</li> <li>- F V tombino kendrejtë b/a C 16/20</li> <li>- F.V. Zgara hekuri D8mm , 20x20 cm</li> <li>- Prishje trotuari ekzistues</li> <li>- Prishje shtresa betoni</li> <li>- Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç te perzier M 15</li> <li>- </li> </ul>
Inxhinier Hidroteknik	<ul style="list-style-type: none"> <li>- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm</li> <li>- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm</li> <li>- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm</li> <li>- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=600 mm</li> </ul>
Inxhinier Mekanik	<ul style="list-style-type: none"> <li>- FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm</li> <li>- FV tabela te medha informative te thjeshta + bazamenti</li> <li>- Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm. Bikomponente (sprajt)</li> <li>- Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Termoplastike (paste)</li> <li>- F.V. Stola betonarme</li> <li>- F.V. Kosha per mbeturina</li> </ul>
Inxhinier Elektrik	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Cmontim i shtylle egzistuese</li> <li>- Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret)</li> <li>- F V kuader komandimi komplekt me santeri+fotoelement</li> <li>- FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086</li> <li>- F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m</li> <li>- F.V. Shtylle metalike H=8ml perfshire ndricuesin LED morseteri , siguresa &amp; kapak</li> <li>- F.V. Shtylle metalike H=4ml perfshire ndricuesin LED morseteri , siguresa &amp; kapak</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- F.V. Spote ndrycues trotuari</li> <li>- F.V. Kabell elektrike FG7OR 5x25 mm2</li> <li>- F.V. Kabell elektrike FG7OR 5x16mm2</li> <li>- F.V. Kabell elektrike FG7OR 3x15 mm2</li> <li>- F.V. Tub plastik flesibel elektriku D75 cm</li> </ul>
Inxhinier Gjeodet	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik
Inxhinier Mjedisi	F.V. Fidane Lule dekorative F.V. Fidane Peme dekorative F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander" Preje e sistemim pemesh ø 21 ~ 40 cm

### 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikoje prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Kriteri konsiderohet i përbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

**Argumentimi 2.3.4:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësiperme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësimë të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedisin dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për

zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet te jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” rekomandohet te jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 135 persona** për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave.

Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përbajë kërkosat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpala publikimit të njofimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

**Argumentimi:** Në përcaktimin e numrit te punonjësve projektuesi ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagen minimale te lejuar qe duhen për të përbushur kontratësn. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muaj, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, përrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkosat themelore të kualifikimit, përpinqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangjen e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim te paktën **135** persona duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njojur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zoterojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport) zëri fuqi punëtore zë rrëth 20% të kostos.

Total ore pune= 142,560 ore (referuar oreve te punes per cdo ze pune te preventivit)

Ore/1 dite pune= 8 ore

Total Dite pune puntori= 142,560 ore/8 ore= 17,820 dite pune

Dite pune gjithesej= 6 muaj (sipas grafikut te punimeve) \* 22 dite/muaj= 132 dite pune

Numri I fuqise pumtore = 17,820 dite / 132 dite = 135 punonjes

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi/qira/kontrate furnizimi).

Nr	Lloji i makinerive	Njësia	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira

2	Kamionçinë	Copë	2	Në pronësi ose me qira
3	Kamion me vinç	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Autobot uji	Copë	2	Në pronësi ose me qira
5	Autobetoniere	Copë	2	Në pronësi ose me qira
6	Autopompë betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Autobitumatriçe	Copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Asfaltoshtruese	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Eskavatorë me zinxhirë	Copë	2	Në pronësi ose me qira
11	Minieskavator	Copë	2	Në pronësi ose me qira
12	Rul gomë-hekur	Copë	2	Në pronësi ose me qira
13	Rul gomë-gomë	Copë	2	Në pronësi ose me qira
14	Rul hekur-hekur	Copë	2	Në pronësi ose me qira
15	Minifadromë	Copë	1	Në pronësi ose me qira
16	Makineri vijëzimi me bojë termoplastike (sprajt)	Copë	1	Në pronësi ose me qira
17	Fabrikë betoni (e pajisur me leje mjedisore kodI III.1.B)	Copë	1	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi
18	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodI III.1.B)	Copë	1	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi
19	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodI III.1.B)	Copë	1	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- a)Për mjetet me rrøta që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b)Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerase/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c)Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përbmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përbajë kërkesat e autoritetit.\_Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe njësies së afateve të ankimit, i kérkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Argumentimi i mjeteve është si mëposhtë:

Nr	Lloji i makinerive	Argumentimi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km Traansport materialesh
2	Kamionçinë	
3	Eskavator me cekic	Prishje trotuari ekzistues Prishje shtresa betoni
4	Autobot uji	Shtrese stabilizant t=15cm Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri
5	Autobetoniere	Struktura monolite betoni C 12/15 (2)
6	Autopompë betoni	Struktura monolite betoni C 16/20 F V tombino kendrejtë b/a C 16/20
7	Autobitumatriçe	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
8	Asfaltoshtuese	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri
9	Eskavator me goma Eskavatorë me zinxhirë Minieskavator	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjetGermim dheu me ekskavator zingjir, 1.0 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III
10	Kamion me vinç	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=600 mm Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret) F.V. Shtylle metalike H=8ml perfshire ndricuesin LED morseteri , siguresa & kapak

		F.V. Shtylle metalike H=4ml perfshire ndricuesin LED morseteri , siguresa & kapak
11	Rul gomë-hekur	Shtrese stabilizant t=15cm
12	Rul gomë-gomë	Shtrese stabilizant t=15cm
13	Rul hekur-hekur	Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri
14	Makineri vijëzimi me bojë termoplastike (sprajt)	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm FV tabela te medha informative te thjeshta + bazamenti Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm. Bikomponente (sprajt) Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Termoplastike (paste)
15	Fabrikë betoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B	Struktura monolite betoni C 12/15 (2) Struktura monolite betoni C 16/20 F V tombino kendrejt b/a C 16/20
16	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri
17	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)	Shtrese stabilizant t=15cm Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri

### 2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë)
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitura e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërise.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik*

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë originale ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në original ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

-Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njojen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe. Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara

nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standartet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standartet e këruara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arrijen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përmëbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standartet e këruara të cilësisë, përfshirë edhe standartet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

#### 4.4 Kriteret e përgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- |   |       |    |
|---|-------|----|
| 1. Çmimi  | pikët | 65 |
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë | pikët | 15 |
| 3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)        | pikët | 10 |
| 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)                                    | pikët | 5  |
| 5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) | pikët | 5  |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

#### Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të janë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të janë 100.

Kriteri:

#### 1. Çmimi [0 - 65] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{min k1} \times P_{max k1} / O_{k1}$$

- $P_{k1}$  Pikët e kriterit që vlerësohet  
 $V_{min k1}$  Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet  
 $P_{max k1}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet  
 $O_{k1}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

#### 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë

[0 –15 pikë]

Operatori Ekonomik per te vleresuar per kete kriter duhet të provoje se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar ne eksperientat e mëparshme të ngashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

- Punime shtresë asfaltobetoni me sipërfaqe jo me pak se  $11,000 \text{ m}^2$  për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit 6 pikë

- Punime per trotuar me pllaka guri me sipërfaqe jo me pak se  $8,700 \text{ m}^2$  për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit 9 pikë

\* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përbushjen e kushtit të afatit 1 vjecar, afat i cili nënkupton një periudhë 12 mujore të pandërprere gjatë 5 viteve kalendarike. Kriteri eshte vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifisht vlera e punime dhe volume te kryera te realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standarde; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për tu vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë "0" pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{maxk2} / V_{maxk2}$$

$P_{k2}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{maxk2}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)

$P_{maxk2}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k2}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik si dhe dorezimit te detyrueshem te informacionit te përbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

### 3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

**Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:**

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{maxk3} / V_{maxk3}$$

$P_{k3}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{maxk3}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{maxk3}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k3}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

### 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 5 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{maxk4} / V_{maxk4}$$

$P_{k4}$  Pikët e kriterit që vlerësohet  
 $V_{maxk4}$  Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet  
 $P_{maxk4}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet  
 $O_{k4}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

**Shënim:** *Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtoja 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.*

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

## 5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur ne mënyrë të posacme edhe me përbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, elemiinit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, perfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatese të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë per përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shëmangjen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndesisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet ne Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike ne masen jo me pak se 3%, përllogaritur në përputhje me madhësinë e projekteve që do të realizohet sipas percaktimeve te VKM nr. 216 date 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur ne vlerë, në këtë rast jo më pak se **7,102,484.29** leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e irregulloreve për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Permbajtja minimale e planit te sigurise ne kantieret e perkoheshme e te levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria ne kantier/shendetë, impakti ne mjedisë dhe sociale, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik per zerin Siguria ne kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit ne Këtë PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e perfshire ne oferten ekonomike te detajuar, konkretisht sipas Shtojces 2 te DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- *Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera: 7,102,484.29 leke pa tvsh.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 7,102,484.29 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 7,102,484.29 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriteri përllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = \frac{O_{k5}}{V_{maxk5}} \times P_{maxk5}$$

$P_{k5}$	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{maxk5}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{maxk5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
$O_{k5}$	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

#### Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendetë, impakti ne mjedisë dhe sociale (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendetë, impakti ne mjedisë dhe sociale (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendetë, impakti ne mjedisë dhe sociale” **nëse vlera e saj do të jetë më shume se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendetë impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O	– (pikët e Ofertës)
Mo	– Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme
N	– Numri i ofertave të vlefshme
PR (Rrm)	– Rritje e mundshme
Mo	= O1 + O2 + O3 + ... On / N
PR	= 200 % Mo

Vlera e ofertave të ofruara > PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendetë impakti ne mjedis”.

**Kujdes!!!**

*Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.*

*Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.*

*Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.*

*Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke ) dhe vlerësohet me 0 pikë.*

*Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.*

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkopon edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

*Specifikimet teknike, rapporti teknik, preventivi me zerat e punimeve janë pjesë e pandare e DST.*

**Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.**